



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT I SHKURTËR

Nga procesverbali i mbledhjes së 14-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 24.05.2023, në sallën numër 2 kati i 3-të, në ora 14,⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
3. Shahadije Bikliqi Dragaçina, anëtare
4. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
5. Enver Kryeziu, anëtar
6. Idajet Garip, anëtar
7. Zoran Cirkovic, anëtar
8. Ana Guciç, anëtare
9. Sllavisa Trajkovic

Të tjerë prezent

1. Sead Aliu, Drejtor i Infrastrukturës Lokale
2. Lidia Jovanovic, ZLK
3. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
4. Përfaqësues të OSBE-së,
5. Të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**,

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Aprovimi i Ekstrakteve nga mbledhja 12 dhe 13 të Komitetit për Komunitete
2. Informatë nga drejtorati për Infrastruktura lokale për projektet ku banojnë komunitetet jo shumicë
3. Raporti i punës së ZLK-së
4. Të ndryshme

Pastaj kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i Ekstrakteve nga mbledhja 12 dhe 13 të Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime të ekstrakteve nga mbledhja 12 dhe 13-të e Komitetit për Komunitete?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht votoi.

Pastaj tha kryesuesi po kalojmë në pikën e 3-të deri sa të vjen drejtori.

III

Raporti mujor i punës së ZKK-së

Lidhur me raportin e punës së ZLK-së, Kryesuesi ia kaloi fjalën Lidia Jovanovic, e cila në pika të shkurta i njoftoi, rreth raportit.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Shahadije Dragaçina, tha se sa i përket familjes së Ajredin Gashit në Janjevë, a do të ndihmohet a jo pasi që u thanë nëse ka marrë një herë ndihmë nuk mund të marrë herën e dytë.

Gentianë Hoxhaj, tha se si është puna me këtë familje a e kanë pronën në emër të vet a jo.

Skender Biliqi, tha se ajo familje është në gjendje të rëndë dhe duhet të ju ndihmohet pasi që po rrezikohet çdo ditë.

Lidija Jovanovic, tha se ne jemi duke u munduar ti ndihmojmë asaj familje por problemi qëndron se ajo familje nuk ka pronë në emër të vetin dhe pa e pas pronën në emër të vetit nuk mund të ju ndërtohet shtëpia.

II

Informatë nga drejtorati për Infrastruktura lokale për projektet ku banojnë komunitetet jo shumicë

Lidhur me këtë pikë kryesuesi ia kaloi fjalën Sead Aliut drejtor i infrastrukturës lokale, i cili në pika të shkurta i njoftoi, rreth Informatës..

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se ne si komitet vitin e kaluar kemi dalë në teren dhe kemi dalë me disa rekomandime, të cilat disa janë marrë parasysh disa të tjera jo. Është mirë që gjatë përpilimit të buxhetit të merren parasysh rekomandimet e komitetit dhe të

hyjnë edhe këto projekte. Po ashtu në Gadime është ndërtuar një çerdhe kryesisht për komunitet por është mirë që të fasadohet edhe jashtë.

Idajet Garip, tha se në Janjevë rruga “Smajl Gradica” kur pritet që të asfaltohet pasi është gjendje shumë të keqe.

Zoran Cirkovic, tha se u përmenden nga drejtori shumë komiteteve ku banojnë komunitetet në Janjevë Gadime, Magurë, por nuk u përmend asnjë projekt ku banojnë komuniteti Serb ,Malazet në Grackë Rubovc dhe në Lipjan.

Sead Aliu, tha se do të mundohemi që ti përfshijmë të gjitha projektet në të ardhmen por për momentin nuk kemi mundësi buxhetore. Sa i përket grackës, ne do të bëjmë pastrimin e varrezave ku përfshihen të gjitha komunitetet duke përfshirë edhe ato në grackë.

Lumturje Bytyqi-Hasnai, tha se sa i përket dy projekteve të mëdha për qytetarët, QKMF-së dhe Shtëpisë së Kulturës, kur pritet të fillojnë këto dy projekte?

Sead Aliu, tha se sa i përket këtyre projekteve dhe disa projekte të tjera të mëdha zakonisht këto po shkojnë më gjatë pasi që po ka ankesa dhe po shkojnë ankesat gjatë.

IV

Të ndryshme

Skender Bikliqi, tha se ne si komiteti i kemi vizituar komunitetet në Janjevë dhe Gadime, por është mirë që të kemi edhe një vizitë në Grackë dhe Lipjan të komuniteti serb.

Gentianë Hoxhaj, tha se është mirë edhe në Mgaure dhe Medvec ta kemi një vizitë ku banojnë komunitetet.

Sllavisha Trajkovic, tha se në Lipjan po e shihni që gjendja e infrastrukturës është e mirë, por duhet që të kemi një vizitë në Grackë dhe Rubovc.

Zoran Cikrovic, tha se pajtohem edhe unë që të kemi vizita në teren, por jo në korrik, po të jetë diku në muajin shtator. Me këtë propozim u pajtuan të gjithë anëtarët e komunitetit dhe u pajtuan që vizita të komuniteti serb të

bëhet në muajin shtator.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15³⁰.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Skender Bikliqi